



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0054399/25 dt. 03.09.2025

Mitrovicë

Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; Kryesuesja e Kuvendit të Komunës për të **enjtën** më dt. **11.09.2025**:

T H Ë R R E T

Mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës
Seanca e 41-të

Mbledhja do të ketë këtë:

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Draft-buxheti për vitin 2026 vlerësimet për 2027 dhe 2028
3. Propozim-vendim për plotësim dhe ndryshim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0021659-2/25 dt. 28.04.2025
4. Shqyrtimi i kërkesave të OJQ-ve për përkrahje financiare
5. Raporti financiar për periudhën janar-qershor 2025
6. Dorëheqja e z. Hysen Muzliukaj nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës
7. Pyetje dhe përgjigje

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit duke filluar nga ora 10:00.

Mitrovicë

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0035824-1/25 dt. 30.06.2025
Mitrovicë

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e 40-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

Koha: 30.06.2025 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Hamdi Hasani, Egzon Hamza, Lavdim Zeneli, Nafije Rexha, Mentor Vinarci, Shkurta Shosholli Musa, Naser Muja, Kushtrim Zeneli, Ekrem Sadiku, Armend Begu, Hysen Muzliukaj, Jeton Zeneli, Erseka Barani, Xhyljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj, Sevdaim Uka, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Ardita Aliu, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Vesel Neziri.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Nënkryetari i Komunës Z. Arian Tahiri

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Munguan: Shkëlqim Ibrahim, Faruk Mujka, Elidiana Budini Haziri, Xhevrije Bahtiri Ademi dhe Muhamed Hoti

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit Znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja e Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 40-të të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje, fillimisht para se me hap për diskutim rendin e ditës dua të ju njoftoj se të gjithë e keni para vetës një dokument i cili është komunikimi i Komunës me MAPL sa i përket pikës së hartave zonale të dt 28.04.2025 për të marrur një vendim për këtë çështje unë i ftoj përfaqësuesit e të gjitha partive politike për të shkuar për një konsult në zyren time, pra nga gjitha partit e ftoj nga një përfaqësues.

Pas konsultimit të Kryesues të kuvendit me përfaqësuesit e partive, grupi i LVV e lëshojë mbledhjen.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Atëherë, po vazhdojmë me mbledhjen. Konstatoj që njëzet e tre anëtarë të Asamblesë janë të pranishëm, kështu që kemi kuorum për të vazhduar me seancën. Kemi mbetur te miratimi i rendit të ditës, andaj së pari po e hap për diskutim, nëse ka dikush diçka lidhur me rendin e ditës. Nëse jo atëherë po vazhdojmë me miratim të rendit të ditës, si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar mbledhjes të rregullt të Kuvendit të Komunës të dt. 28.04.2025
2. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028
2.1 Informatë Qarkorja Buxhetore 2026/1
3. Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Aksionareve KRM Uniteti

- 4 Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të në procedurën e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrje Publike
- 5 Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave të në procedurën e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrje Publike
- 6 Propozim vendimi për zëvendësimin e anëtarit të ri të Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve, zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo-arsim
- 7 Raport i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024
- 8 Raport financiar për periudhën janar-mars 2025
- 9 Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit: 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Rendin e ditës.

Pika 1

Kryesuesja e Kuvendit sa i përket Mbledhjes së rregullt të Kuvendit të Komunës, datë njëzet e tetë prill dy mijë e njëzet e pesë, në diskutim me përfaqësues të partive politike në takimin e mëparshëm, e kemi trajtuar çështjen e komunikimit me MAPL, ose më saktësisht, kërkesën e tyre lidhur me votimin e pikës së dytë të rendit të ditës për hartat zonale. Ministria ka kërkuar që pika në fjalë të dërgohet si vendim për miratim të ligjshmërisë nga ana e tyre, pasi ata e konsiderojnë se, me 17 vota për, dhe me tridhjetë e tre anëtarë të Asamblesë të pranishëm, pika është miratuar. Për ta dërguar vendimin për shqyrtim apo për ta nënshkruar atë, unë kam konsideruar të nevojshme që të ndryshohet dhe të plotësohet procesverbali i asaj mbledhjeje, pasi aktualisht në procesverbal është konstatuar se pika në fjalë nuk është miratuar. Kështu që, duke ia bashkangjitur procesverbalit edhe komunikimin me Ministrinë, të cilin e keni secili para vetes, unë kërkoj nga ju që për pikat dy, katër dhe shtatë pasi Ministria iu është referuar vetëm pikës dy, ndërsa analogjia e ngjashme vlen edhe për pikat katër dhe shtatë të rendit të ditës të datës njëzet e tetë prill të konstatojmë se këto tri pika janë të miratuara. Në këtë mënyrë, besoj se do ta kemi edhe anën ligjore të përfunduar lidhur me nënshkrimin e vendimeve për këto tri pika në fjalë. Theksoj është vetëm në ndryshimin e konstatimit në procesverbal, jo në shtimin e ndonjë pike të re. Pjesë e këtij procesverbali do të jenë edhe komunikimet me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe konstatimet për pikat dy, katër dhe shtatë, që nga “nuk miratohen” të bëhen “miratohen”, në bazë të kërkesës së Ministrisë. Nëse ka dikush për të diskutuar lidhur me procesverbalin po e hap për diskutim.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Procesverbalin lidhur me procesin e votimit të pikave 2, 4, dhe 7 të rendit të ditës duke u bazuar në shkresat e MAPL-së (të cilat do të janë pjesë e këtij procesverbali) të ndryshohet teksti si në vijim:

Konstatimi lidhur me votimin e pikës së 2-të të rendit të ditës të ndryshohet me tekstin: Miratohet Vendimi për miratimin e Hartës zonale të Komunës së Mitrovicës Jugut 2024-2032.

Konstatimi lidhur me votimin e pikës së 4-të të rendit të ditës të ndryshohet me tekstin: Miratohet Kërkesa e Sindikatës së të Punësuarve në Komunën e Mitrovicës për mbështetje financiare.

Konstatimi lidhur me votimin e pikës së 7-të të rendit të ditës të ndryshohet me tekstin: Miratohet Plani i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025.

Atëherë kush është që të miratohet procesverbali me këto ndryshime?

Rezultati i votimit: 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht me ndryshime.

Pika 2

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe Qarkoren Buxhetore 2026/1.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe konstatoj që janë të pranishëm njëzet e një anëtarë të Asamblesë.

Rezultati i votimit: 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028.

Pika 3

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja sa i përket Propozim-vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Aksionerëve KRM Uniteti, ju njoftojmë se z. Hamdi Hasani, anëtar dhe kryesues i këtij komisioni, ka dhënë dorëheqje. Për këtë arsye, nga e njëjta parti kërkohet që të bëhet propozimi i ri për anëtarin zëvendësues të Komisionit të Aksionerëve.

Fisnik Suma në emër të Partisë Demokratike propozojmë z. Fadil Veselin.

Kryesuesja e Kuvendit a ka propozime tjera? Pasi nuk kishte të lajmëruar të tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim propozim-vendimin për zëvendësimin Z. Hamdi Hasani (i cili ka dhënë dorëheqje), dhe emërimin e anëtarit Z. Fadil Veseli Anëtar i Komisionit të Aksionerëve KRM Uniteti.

Rezultati i votimit: 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për emërimin e z. Fadil Veseli Anëtar i Komisionit të Aksionerëve KRM Uniteti.

Pika 4

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja sa i përket Propozim-vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike. Kemi dorëheqjen e z. Lavdim Zeneli, njëkohësisht edhe kryesues i këtij komisioni, kështu që nga subjekti i njëjtë politik kërkohet emri për zëvendësim.

Fisnik Krasniqi: Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës propozojmë Z. Fisnik Suma.

Kryesuesja e Kuvendit a ka propozime tjera? Pasi nuk kishte të lajmëruar të tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim propozim-vendimin për zëvendësimin Z. Lavdim Zeneli (i cili ka dhënë dorëheqje), dhe emërimin e anëtarit Z. Fisnik Suma Anëtar i Komisionit të për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve të NPL-ve.

Rezultati i votimit: 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për emërimin e z. Fisnik Suma Anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.

Pika 5

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Sa i përket propozim-vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike, ju njoftoj se znj. Drita Kadriu ka dhënë dorëheqje nga ky komision. Kjo për shkak se, duke qenë anëtare e komisioneve të Bordit të Aksionerëve, ka rezultuar të ketë konflikt interesi me këtë angazhim. Duke qenë se zëvendësimi i saj duhet të bëhet, propozimi për anëtar të ri duhet të vijë nga ekzekutivi, sipas procedurave në fuqi. Megjithatë, para nesh qëndron një sfidë, pasi aktualisht të tri drejtoreshat janë pjesë e komisioneve të Aksionerëve, dhe ligji nuk lejon një përfaqësim të balancuar 50-50 në aspektin gjinor në këtë rast. Për të respektuar dispozitat ligjore, është e domosdoshme që përfaqësuesja nga Asambleja të jetë e gjinisë femërore, ndërsa përfaqësuesi nga ekzekutivi të jetë i gjinisë mashkullore. Përndryshe, komisioni nuk mund të formohet në përputhje me kriteret ligjore. Pasi u dakorduam për vazhdimin e kësaj pike të rendit të ditës, kalojmë te propozimet për zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike.

Në emër të Partisë Demokratike, z. Fisnik Krasniqi propozoi znj. Majlinda Kurti për të zëvendësuar z. Fisnik Suma, i cili largohet nga ky komision.

Gjithashtu, nga ekzekutivi, Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza propozoi z. Egzon Sadiku për të zëvendësuar znj. Drita Kadriu, e cila ka dhënë dorëheqje për shkak të konfliktit të interesit.

Kryesuesja e Kuvendit pra kështu, në këtë pikë kemi dy zëvendësime:

Z. Fisnik Suma zëvendësohet nga znj. Majlinda Kurti;

Znj. Drita Kadriu zëvendësohet nga z. Egzon Sadiku.

Kryesuesja e Kuvendit pyeti nëse ka ndonjë propozim tjetër. Pasi nuk kishte të lajmëruar të tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim propozim-vendimin për zëvendësimin Z. Fisnik Suma dhe emërimin e anëtares znj. Majlinda Kurti Anëtare e Komisionit të për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së Bordit e Drejtorëve të NPL-ve.

Rezultati i votimit: 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për emërimin e znj. Majlinda Kurti Anëtare e Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.

Kryesuesja e Kuvendit e vuri në votim propozim-vendimin për zëvendësimin znj. Drita Kadriu (e cili ka dhënë dorëheqje), dhe emërimin e anëtarit z. Egzon Sadiku Anëtar i Komisionit të për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së Bordit e Drejtorëve të NPL-ve

Rezultati i votimit: 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për emërimin e z. Egzon Sadiku Anëtar i Komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e përzgjedhjes së anëtarëve në Bordet e Drejtorëve të NPL-ve.

Pika 6

Kryesuesja e Kuvendit po ashtu sa i përket Propozim-vendimit për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore. Drejtoresha e DA znj. Drita Kadriu na na ka ofruar dorëheqjen e z. Fisnik Çitaku dhe ka paraqitur propozimin për zëvendësim me znj. Elmaze Hasani. A ka dikush për diskutim.

Gjergj Beka: Vetëm disa sqarime me drejtoreshën, për punën dhe shkollimin e anëtares së re. Sipas informatave që kam, ajo ka kryer vetë shkollimin e lartë, si drejtoreshë. Sa kam informacion për këtë, mora fjalën për të sqaruar, sepse në bazë të ligjit më duket se duhet të ketë të paktën një kriter për të qenë pjesë e komisionit. Gjithashtu, duhet të jetë dikush nga stafi i tyre.

Drita Kadriu: Drejtoresha znj. Elmaze Hasani ka përvojë të gjatë në arsim dhe në detyrat e udhëheqjes, ndërsa kualifikimin e ka nga Fakulteti Filozofik, dega Gjuhë dhe Letërsi Shqipe. Sa unë kam informacion, ndërsa praktikat tona dhe interpretimi nga Ministria e Administratës Publike për komisionin e kaluar ka qenë që edhe drejtorët janë pjesë e DKA-së.

Kryesuesja e Kuvendit pyeti nëse ka ndonjë propozim tjetër. Pasi nuk kishte të lajmëruar të tjerë për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim propozim-vendimin për zëvendësimin e z. Fisnik Çitaku (i cili ka dhënë dorëheqje), dhe emërimin e anëtares Znj. Elmaze Hasani Anëtare e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore, dhe konstatoj që janë të pranishëm nëntëmbëdhjetë anëtarë të Asamblesë.

Rezultati i votimit: 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar Vendimin për emërimin e znj. Elmaze Hasani Anëtare e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore.

Pika 7

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Raport i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Raport i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024 dhe konstatoj që janë të pranishëm nëntëmbëdhjetë anëtarë të Asamblesë.

Rezultati i votimit: 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.

Pika 8

Kryesuesja hapi diskutimin lidhur me Raport financiar për periudhën janar-mars 2025.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesja e vuri në votim Raportin financiar për periudhën janar-mars 2025.

Rezultati i votimit: 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar unanimisht Raportin financiar për periudhën janar-mars 2025.

Pika 9

Xhyljeta Imeri: Dua të ndalem më tepër te Drejtoria e Arsimit. Klasa aneks në shkollën “Aziz Sylejmani”, paralelja në Suhodoll, është për mua – dhe besoj edhe për të tjerët e papranueshme që ndërtimi i saj të mos përfshihet në prioritetet e Drejtorisë së Arsimit për këtë vit. Sidomos duke pasur parasysh profesionin tuaj në këtë fushë dhe faktin që personalisht e keni parë këtë hapësirë të improvizuar, e cila nuk i plotëson as kushtet minimale për mësim. Për këtë qëllim, me kërkesë time dhe me miratimin e kryetarit, janë ndarë katërdhjetë mijë euro për vitin e kaluar, por fatkeqësisht këto mjete janë tërhequr nga përmbaruesi. Te çerdhja “Gëzimi Ynë” në Shqipol, përzgjedhja e stafit është e mirëpritur, por procesi është i paplotë, duke marrë parasysh mungesën e psikologut dhe asistentit për fëmijët me nevoja të veçanta, të cilët janë të domosdoshëm për zhvillimin e fëmijërisë së hershme dhe për funksionimin e institucionit. Gjatë gjithë mandatit tim, kam ngritur kërkesën për punësimin e psikologëve dhe asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta në shkollë. Këto pozita janë planifikuar edhe në planin tuaj për këtë vit, prandaj kërkoj të kuptoj: pse ende nuk janë hapur konkurset për këto vende pune? Klasa parafillore në shkollën “Aziz Sylejmani” në Mitrovicë – sipas Ligjit për fëmijërinë e hershme, çdo shkollë obligohet të ketë një klasë parafillore. Megjithatë, kjo shkollë është e vetmja në qytet që ende nuk ka klasë parafillore, edhe pse ka pasur kërkesa të vazhdueshme nga udhëheqësia e shkollës dhe nga ana ime. Kërkoj: Punësimin sa më të shpejtë dhe funksionalizimin e çerddes “Gëzimi Ynë” në Shqipol, me psikolog dhe asistent; Hapjen e klasës parafillore në shkollën “Aziz Sylejmani” në Mitrovicë; Ndërtimin e aneksit të klasës në Suhodoll. Kërkoj që këto procese të përfundojnë para muajve korrik-tetor. Gjithashtu, kam një kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës, për rifunksionalizimin sa më të shpejtë të rrjetit elektrik në rrugën “Hoxhë Hasan Tasini”, një zonë me dendësi të lartë banorësh, që vazhdimisht paraqet ankesa për mungesën e ndriçimit publik, gjë që ndikon negativisht në jetën dhe sigurinë e tyre. Ky problem kërkon zgjidhje të menjëhershme.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Faleminderit shumë, zonja Imeri! Me të drejtë i keni ngritur këto çështje. Sa i përket punësimit të psikologëve dhe asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta, është më se e domosdoshme dhe besoj se do të gjejmë mënyrën për të proceduar më tutje. Komuna e Mitrovicës nuk ka tejkaluar kurrë numrin e të punësuarve në raport me numrin e aprovuar në buxhet. Mirëpo, para disa kohësh kemi pranuar një shkresë nga Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave. Për shkak të rritjes së pagave me një koeficient prej 55 eurosh, që hyri në fuqi nga fillimi i vitit – kjo ka ndodhur pas miratimit të buxhetit – buxheti për masën e pagave nuk është rritur në përputhje me këtë. Prandaj, kjo ka shkaktuar një deficit në pagat dhe jemi të detyruar të ndërpresim rekrutimin në disa pozita derisa të sqarohet situata. Jam i bindur se do të insistojmë për rritjen e masës së pagave dhe për hapjen e vendeve të punës. Sa i përket kërkesave për shkollën në Suhodoll, shkollën “Aziz Sylejmani” dhe rrugën që u përmend, kërkoj nga drejtorët të kryejnë punët me urgjencë, sepse afati i mandatit është në fund dhe këto projekte duhet të përfundojnë. Institucionet kanë vazhdimësi dhe Komuna e Mitrovicës do të vazhdojë të punojë për nevojat e qytetarëve edhe në të ardhmen. Faleminderit shumë për çështjet që ngritët!

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:09 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:

Kryesuesja e Kuvendit

Afërdita MAXHUNI

Vesa BROJA



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Mitrovica Juzna– Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	29.08.2025
REFERENC-Ë:	02-400/01-0053328/25
PËR/ZA/TO:	znj. Vesa BROJA – Kryesuese e Kuvendit
KOPJE :	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Bedri HAMZA – Kryetar i Komunës së Mitrovicës
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Draft Buxheti për vitin 2026 dhe vlerësimat për 2027 dhe 2028

E nderuar,

Duke u mbështetur në obligimet që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit Nr. 03/L-048 me plotësimet dhe ndryshimet përkatëse, Qarkoret Buxhetore 2026/01 dhe 2026/02, si dhe Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 dhe dëgjimet buxhetore me qytetarë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës ka përgatitur Draft-Buxhetin për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028.

Ju njoftojmë se afati i fundit për dorëzimin e Buxhetit të aprovuar nga Kuvendi Komunal në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve është **30 shtator 2025**. Ju lutem të keni parasysh edhe procesin teknik të regjistrimit të të dhënave në sistemet BDMS dhe PIP nga zyrtarët përgjegjës.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of South Mitrovica

BUXHETI KOMUNAL

2026 - 2028

GUSHT 2025

<https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/>

Përmbajtja

.....	1
BUXHETI I KOMUNËS SË MITROVICËS	3
Përmbledhje.....	3
Procesi i hartimit të Draft-Buxhetit 2026-2028.....	3
Planifikimi i të hyrave vetanake komunale për vitin 2026 – 2028.....	4
Planifikimi i Buxhetit sipas Programeve Buxhetore për vitin 2026 - 2028	8
Planifikimi i investimeve kapitale për vitin 2026 – 2028	16
Planifikimi analitikë i Buxhetit për vitet 2026-2028.....	21

BUXHETI I KOMUNËS SË MITROVICËS

Buxheti Komunal për vitin 2026 planifikohet në bazë të obligimeve dhe detyrimeve që dalin nga Statuti i Komunës së Mitrovicës dhe është i bazuar në realizimin e buxhetit komunal për vitin 2024, Buxhetit të komunave të Kosovës për vitin 2026 të përcaktuar nga Komisioni i Granteve Qeveritare dhe të miratuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Kuvendi i Kosovës, në mbështetje të Qarkoreve buxhetore 2026/01 dhe 2026/02 dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kosovës për vitin 2026-2028, buxhetimit programor si dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028 për të hyrat dhe shpenzimet, për programet buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe atë nga Granti Qeveritar dhe nga të Hyrat Vetanake.

Përmbledhje

Më 30 Qershor 2025, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës miratoi Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028, e ndërtuar në përputhje me procedurat e parashikuara buxhetore 2026-2028. Korniza afatmesme buxhetore si dokument strategjik ka siguruar ndarjen fillestare të Buxhetit, duke u bazuar në kërkesat e Drejtorive Komunale. Me rastin e regjistrimit të popullsisë, të dhënat e publikuara zyrtarisht nga **Agjencia e Statistikave të Kosovës** në vitin 2024 janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më **12.03.2025**, përmes **Shtojcës 1**, në përputhje me nenin 35, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Këto të dhëna kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e buxhetit komunal për periudhën 2026–2028.

Në këtë kuadër, **Komuna e Mitrovicës** ka një ndikim negativ në numrin e stafit, përkatësisht **34 pozita më pak** krahasuar me vitin aktual fiskal.

Procesi i hartimit të Draft-Buxhetit 2026-2028

Organizata buxhetore (642) ka zhvilluar procesin e hartimit të Draft-Buxhetit për vitet 2026-2028, në harmoni të plotë me instruksionet e dhëna nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes Qarkoreve buxhetore 2026/01 dhe 2026/02, në harmoni me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026-2028 (KAB), Dëgjimeve Buxhetore me qytetarë dhe me Drejtorët/et Komunal si dhe në zbatim të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë, me qëllim që finalizimi i tij të jetë në përputhje me interesat e qytetarëve të komunës sonë, në varshmëri për atë sa edhe kanë lejuar kufinjët e limituar të financimit. Projekt-buxheti përveç burimeve të financimit apo burimeve të fondeve për hartimin e tij, përmban edhe projeksionet e shpenzimeve dhe prioritetet e qeverisë lokale të shpërndara në pesë kategori ekonomike të shpenzimeve.

MFPT ka hartuar Qarkoret buxhetore, bazuar në të dhënat e përcaktuara nga Komisioni i Granteve, i cili ka mandatin e përcaktimit të vlerës së granteve duke zbatuar kriteret e përcaktuara si numri i popullsisë, numri i nxënësve, numrin i pakicave kombëtare etj. Nga këto përcaktime të Komisionit të Granteve ka rezultuar se buxheti i organizatës sonë buxhetore për **vitin 2026** do të ketë shumën prej **32,418,756.00 €**.

Grantet Qeveritare dhe të Hyrat Vetanake Komunale 2026 – 2028				
Nr.	Përshkrimi	2026	2027	2028
1	Granti i Përgjithshëm	12,898,307.00	13,893,572.00	15,009,975.00
2	Granti specifik për Arsim	11,506,885.00	11,852,092.00	12,207,654.00
3	Granti specifik për shëndetsi	3,651,356.00	3,760,896.00	3,873,723.00
4	Financimi për Teatro	279,708.00	295,092.00	311,322.00
5	Financimi për Shërbime Rezidenciale	382,500.00	415,000.00	415,000.00
	Gjithësej Granti	28,718,756.00	30,216,652.00	31,817,674.00
6	Të Hyrat Vetanake	3,700,000.00	3,942,858.00	3,955,079.00
	Totali i Buxhetit	32,418,756.00	34,159,510.00	35,772,753.00

Tabela 1


Planifikimi i të hyrave vetanake komunale për vitin 2026 – 2028

Përshkrimi i Të Hyrave	Parashikimi 2026	Parashikimi 2027	Parashikimi 2028
Çertifikatat e lindjes	7,000.00	7,000.00	7,000.00
Çertifikatat e kurorëzimit	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Çertifikatat e vdekjes	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Çertifikata tjera	70,000.00	80,000.00	80,000.00
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Administrata dhe Personeli	95,000.00	105,000.00	105,000.00
Taksat për ushtrim të veprimtarisë	40,000.00	40,000.00	40,000.00
Integrimet Evropiane	40,000.00	40,000.00	40,000.00
Gjobat mandatare nga Inspekcioni	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Pranimi teknik i lokalit	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Inspektimet veterinare brenda vendit	10,000.00	10,000.00	10,000.00
Inspeksioni	13,000.00	13,000.00	13,000.00
Tatimi në Pronë dhe Tokë	1,016,041.00	1,089,704.00	1,100,601.00
Tatimi ne Tokë	218,731.00	264,665.00	265,988.00
Taksa e regjistrimit të automjeteve	160,000.00	160,000.00	160,000.00
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Qiraja nga Objektet Publike	5,000.00	5,000.00	5,000.00
Buxhet dhe Financa	1,400,772.00	1,520,369.00	1,532,589.00

Qiraja nga objekti - Therrtorja	7,070.00	7,070.00	7,070.00
Destinimi i tokes	-	-	-
Bujqësia	7,070.00	7,070.00	7,070.00
Leje Mjedisore Komunale	42,000.00	52,000.00	52,000.00
Taksat nga mbeturinat	37,000.00	37,000.00	37,000.00
Pylltaria dhe Inspeksioni	79,000.00	89,000.00	89,000.00
Parkingu publik	25,000.00	25,000.00	25,000.00
Taksa tjera adm. - Meremetimi i varrezave	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Zhvillimi Ekonomik	27,000.00	27,000.00	27,000.00
Regjistrimi i trashëgimisë	130,000.00	130,000.00	130,000.00
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	15,000.00	15,000.00	15,000.00
Shfrytëzimi hapsirës publike (Tokë)	140,000.00	150,000.00	150,000.00
Tax per fletposeduese dhe kopje planiapsirës publike (Tokë)	40,000.00	40,000.00	40,000.00
Gjeodezi dhe Kadastër	325,000.00	335,000.00	335,000.00
Lejet e ndertimit	1,329,258.00	1,381,519.00	1,381,520.00
Destinimi i tokes	50,000.00	60,000.00	60,000.00
Verifikimi i dokumenteve të ndryshme	-	-	-
Legalizimi i objekteve	40,000.00	40,000.00	40,000.00
Taksa për fletëkërkesa	-	-	-
Reklamat	30,000.00	40,000.00	40,000.00
Shfrytëzimi hapsirës publike	40,000.00	50,000.00	50,000.00
Shitja e pasurisë	4,000.00	4,000.00	4,000.00
Qiraja nga objektet publike	11,000.00	12,000.00	12,000.00
Urbanizmi	1,504,258.00	1,587,519.00	1,587,520.00
Marrja e pëlqimeve për armmbajtje	1,500.00	1,500.00	1,500.00
Vertetim per lirim nga shtetesia	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Leje per trashëgimi	100.00	100.00	100.00
Vertetim qe merr ndihma sociale	200.00	200.00	200.00
Vertetim mbi ushtrimin e te drejtes prinderore	1,000.00	1,000.00	1,000.00
Mirëqenia Sociale	3,800.00	3,800.00	3,800.00
Qiraja nga objektet publike - sportive	-	-	-
Participimi i bibliotekës	100.00	100.00	100.00
Participimi nga Teatri	2,000.00	2,000.00	2,000.00
Kulturë, Rini dhe Sport	2,100.00	2,100.00	2,100.00
GJITHËSEJ ADMINISTRATA KOMUNALE	3,497,000.00	3,729,858.00	3,742,079.00
Participimi i Shëndetësisë	40,000.00	50,000.00	50,000.00
GJITHSEJ SHËNDETËSIA	40,000.00	50,000.00	50,000.00
Participimi i Çerdhes së Fëmijëve	100,000.00	100,000.00	100,000.00
Participimi i SH.M.T. Arkitekt Sinani	35,000.00	35,000.00	35,000.00
Participimi i SH.M.E. Hasan Prishtina	25,000.00	25,000.00	25,000.00
Participimi i SH.M.M. Xheladin Deda	3,000.00	3,000.00	3,000.00
GJITHSEJ ARSIMI	163,000.00	163,000.00	163,000.00
T O T A L I	3,700,000.00	3,942,858.00	3,955,079.00

Tabela 2

PJESEMARRJA E GRANTEVE QEVERITAR DHE E TË HYRAVE VETANAKE NË BUXHETIN E VITIT 2026



Grafikoni 1

Përcaktimi i prioriteteve

Është e qartë se njëri ndër segmentet më të rëndësishëm në procesin e hartimit të buxhetit është përcaktimi i prioriteteve sidomos në pjesën e investimeve kapitale.

Bazë e përcaktimit të prioriteteve janë kërkesat e qytetarëve të komunës sonë, për të ngritur mirëqenien e tyre. Prioritet kryesor është Arsimi, Shëndetësia dhe Infrastruktura duke mos lënë anash edhe ngritjen e performancës së shërbimeve ndaj qytetarëve përmes Digjitalizimit të shërbimeve.

Identifikimi i kërkesave

Sipas Orarit për mbajtjen e Dëgjimeve Buxhetore me qytetarë për planifikimin e buxhetit 2026–2028, në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit kemi organizuar katër (4) dëgjime buxhetore me qytetarët, me të cilët është komunikuar për identifikimin e nevojave si dhe kërkesave të tyre, gjithashtu përveç këtyre dëgjimeve buxhetore ka pasur edhe takime të rregullta me qytetarë si dhe në përfundim të procesit të hartimit të buxhetit u organizuan takime dhe dëgjime buxhetore edhe me ZKA, Drejtorët e Drejtorive për finalizimin e Draft-Buxhetit 2026-2028 dhe të listës së Projekteve kapitale.

Gjatë këtij procesi të planifikimit të buxhetit për vitin 2026 dhe vlerësimet 2027-2028 duke vepruar sipas Ligjit për Barazi Gjinore Nr.05/L-20, Organizata Buxhetore është përgjegjëse për përfshirjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, me qëllim të garancës për Barazi Gjinore.

Planifikimi i Buxhetit sipas Programeve Buxhetore për vitin 2026 - 2028

Nenprogrami	Pershkrimi	Stafi	Pagat dhe Meditjet	Mallrat dhe Sherbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe Transferet	Shpenzimet Kapitale	TOTALI 2026	Total 2027	Total 2028
c	d	e	f	g	h	i	j	k	k	l
Mitrovicë	Total Shpenzimet	1965	17,974,714.00	4,920,000.00	600,000.00	1,209,150.00	7,714,892.00	32,418,756.00	34,159,511.00	35,772,753.00
	Granti i Pergjithshem		17,974,714.00	3,638,931.00	600,000.00	24,991.00	6,480,120.00	28,718,756.00	30,216,653.00	31,817,674.00
	Të Hyrat Vetanake		-	1,281,069.00	-	1,184,159.00	1,234,772.00	3,700,000.00	3,942,858.00	3,955,079.00
	Te Hyrat e Bartura 22		-	-	-	-	-	-	-	-
	Financimi nga Huamarrja		-	-	-	-	-	-	-	-
Zyra e Kryetarit	Total Shpenzimet	24	256,065.60	30,000.00	-	-	-	286,065.60	285,365.60	301,081.40
	Granti i Pergjithshem		256,065.60	30,000.00	-	-	-	286,065.60	285,365.60	301,081.40
	Të Hyrat Vetanake		-	-	-	-	-	-	-	-
	Te Hyrat e Bartura 22		-	-	-	-	-	-	-	-
	Financimi nga Huamarrja		-	-	-	-	-	-	-	-
Njësia e Auditimit të Brendshëm	Total Shpenzimet	3	36,556.00	18,000.00	-	-	-	54,556.00	55,556.00	55,556.00
	Granti i Pergjithshem		36,556.00	18,000.00	-	-	-	54,556.00	55,556.00	55,556.00
	Të Hyrat Vetanake		-	-	-	-	-	-	-	-
	Te Hyrat e Bartura 22		-	-	-	-	-	-	-	-
	Financimi nga Huamarrja		-	-	-	-	-	-	-	-

Zyra e Kuvendit Komunal	Total Shpenzimet	33	319,560.00	12,000.00	-	-	-	331,560.00	331,560.00	331,560.00
	Granti i Pergjithshem		319,560.00	12,000.00		-	-	331,560.00	331,560.00	331,560.00
	Të Hyrat Vetanake					-	-	-	-	-
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Administrata	Total Shpenzimet	53	451,910.20	503,282.00	350,400.00	180,000.00	100,000.00	1,585,592.20	1,774,436.20	1,987,415.20
	Granti i Pergjithshem		451,910.20	344,267.00	350,400.00	-	100,000.00	1,246,577.20	1,474,436.20	1,794,441.20
	Të Hyrat Vetanake		-	159,015.00	-	180,000.00	-	339,015.00	300,000.00	192,974.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Çështjet gjinore	Total Shpenzimet	2	21,594.40	6,500.00	-	20,000.00	-	48,094.40	48,094.40	48,094.40
	Granti i Pergjithshem		21,594.40	6,500.00	-	-	-	28,094.40	28,094.40	28,094.40
	Të Hyrat Vetanake		-	-	-	20,000.00	-	20,000.00	20,000.00	20,000.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Integrimet Evropiane	Total Shpenzimet	8	80,789.60	50,000.00	-	300,175.00	44,000.00	474,964.60	304,948.60	418,262.60
	Granti i Pergjithshem		80,789.60	50,000.00	-	-	44,000.00	174,789.60	160,789.60	161,246.60
	Të Hyrat Vetanake		-	-		300,175.00	-	300,175.00	144,159.00	257,016.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-

Inspekcioni	Total Shpenzimet	19	208,065.60	90,000.00	-	-	-	298,065.60	297,065.60	302,065.60
	Granti i Pergjithshem		208,065.60	90,000.00			-	298,065.60	247,065.60	252,065.60
	Të Hyrat Vetanake		-	-			-	-	50,000.00	50,000.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Buxhet dhe Financa	Total Shpenzimet	25	235,199.20	530,000.00	-	-	258,389.00	1,023,588.20	1,524,950.20	4,238,247.20
	Granti i Pergjithshem		235,199.20	30,000.00			202,287.00	467,486.20	916,603.20	2,665,412.20
	Të Hyrat Vetanake		-	500,000.00			56,102.00	556,102.00	608,347.00	1,572,835.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Zjarrëfikësit dhe inspektimet	Total Shpenzimet	41	339,728.00	80,000.00	-	-	320,000.00	739,728.00	599,728.00	640,228.00
	Granti i Pergjithshem		339,728.00	80,000.00	-		320,000.00	739,728.00	599,728.00	640,228.00
	Të Hyrat Vetanake		-	-	-		-	-	-	-
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Menaxhimi i katastrofave natyrore	Total Shpenzimet	4	43,158.40	346,798.00	-	-	-	389,956.40	383,158.40	358,739.40
	Granti i Pergjithshem		43,158.40	224,477.00	-		-	267,635.40	83,158.40	208,739.40
	Të Hyrat Vetanake		-	122,321.00	-		-	122,321.00	300,000.00	150,000.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-

Zyra Lokale për Komunitete dhe Kthim	Total Shpenzimet	6	57,025.60	15,000.00	-	15,000.00	-	87,025.60	87,025.60	87,625.60
	Granti i Pergjithshem		57,025.60	15,000.00	-			72,025.60	72,025.60	72,625.60
	Të Hyrat Vetanake		-	-		15,000.00		15,000.00	15,000.00	15,000.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Bujqësia	Total Shpenzimet	8	88,128.00	20,000.00	-	120,000.00	-	228,128.00	319,762.00	337,291.00
	Granti i Pergjithshem		88,128.00	20,000.00	-		-	108,128.00	118,128.00	113,122.00
	Të Hyrat Vetanake		-	-		120,000.00	-	120,000.00	201,634.00	224,169.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Pyltaria dhe inspeksioni	Total Shpenzimet	6	63,781.60	20,000.00	-	20,000.00	-	103,781.60	88,781.60	93,781.60
	Granti i Pergjithshem		63,781.60	20,000.00	-		-	83,781.60	88,781.60	93,781.60
	Të Hyrat Vetanake		-	-		20,000.00	-	20,000.00	-	-
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-
Zhvillimi Ekonomik	Total Shpenzimet	9	95,158.40	799,698.00	-	-	4,442,191.00	5,337,047.40	5,777,529.40	4,579,944.40
	Granti i Pergjithshem		95,158.40	469,965.00	-		3,263,521.00	3,828,644.40	4,480,779.40	4,279,859.40
	Të Hyrat Vetanake		-	329,733.00	-		1,178,670.00	1,508,403.00	1,296,750.00	300,085.00
	Te Hyrat e Bartura 22							-	-	-
	Financimi nga Huamarrja							-	-	-

Gjeodezi dhe Kadastër	Total Shpenzimet	15	133,250.40	15,000.00	-	-	-	148,250.40	149,678.20	158,250.40
	Granti i Pergjithshem		133,250.40	15,000.00			-	148,250.40	149,678.20	158,250.40
	Të Hyrat Vetanake		-	-			-	-	-	-
	Te Hyrat e Bartura 22						-	-	-	-
	Financimi nga Huamarrja						-	-	-	-
Planifikimi Hapsinor dhe Rregullativ	Total Shpenzimet	14	151,605.60	100,000.00	-	-	-	251,605.60	250,216.60	236,605.60
